VENDIM
Nr.24, datë 28.7.2010

PËR MOSDHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE "RADIO AUTOSTRADA"

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor", rregullores "Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nviel vendor" dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht, sipas vendimit nr.882, datë 28.9.2009 "Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë si operator radiofonik privat vendor shoqërinë "Radio Autostrada" sh.p.k., pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se nga ana e subjektit nuk janë paraqitur struktura organizative, organigrama dhe përmbajtja e disa programeve që do të transmetohen.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 ditëve nga marrja në dijeni, në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati